



**Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët të komunës së Mamushës
Emërohet Këshilli për Veprim Rinor Lokal në Mamushë

17 mars 2014, Prizren

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “Transparenca online e Komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës” ka marrë pjesë në mbledhjen e radhës të kryetarit të komunës së Mamushës, Arif Bütuç me drejtorët komunal ku janë miratuar disa vendime.

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 kryetari I Komunës së Mamushës gjatë muajit shkurt ka marr vendim për njohjen e Këshillit për Veprim Rinor Lokal të Mamushës. Këshilli do të funksionoj si formacion këshillues I organizatave rinore të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Mamushës, me qëllim të përfaqësimit të interesave të organizatave rinore tëk institucionet Komunale në Mamushë. Këshilli sipas ligjit dhe udhëzimit administrativ ka përgjegjësi dhe obligim të fuqizojë organizatat rinore të Komunës së Mamushës, për të ndërtuar një vision të përbashkët për të rinjtë e Komunës së Mamushës. Ky këshillë funksionin e tij e ushtoron në bazë të ligjit për Fuqizim dhe Pjesmarrje të Rinisë Nr.03/L-145, Udhëzimit Administrativ Nr.9.2010 Statutit të Këshillit si dhe Rregullorës së Punës. KVRL do të udhëhiqet nga Mirat Bütuç kryetar, Berna Mazrek nën kryetare, Mevlyde Bütuç sekretar dhe Serdar Thaç arkatar.

Në këtë takim është aprovuar kërkesa e Drejtorisë të Administratës së Përgjithshme për shfrytëzimin e mjeteve për projektin “Veturë Zyrtare”, mjetet do të mirren nga projekti “automjeti për pastrimin e rrugëve” nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në vlerë prej 5 000 euro.

Ka kaluar edhe kërkesa e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave për emërimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për tatimin në pronë në Komunën e Mamushës, komisioni do të ketë përbërje Jahja Mazrek kryetar, Ibrahim Morina dhe Esra Osi anëtar.

Me kërkesën e Drejtorisë së Administratës, është nxjerr vendim për çasje në telefoninë mobile në shërbimin post paid (mujore) për kryesuesin e Kuvendit të Komunës, Menaxherin e Prokurimit, Udhëheqësen e Personelit, Nën kryetarën e Komunës si dhe Zyrtaren kryesore Financiar.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit dhe të Mamushës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Rr. Perandori Dioklician 14 (kati V), 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës"
përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*